



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë/Prishtina, Rr./Ul. Luan Haradinaj tel. +381 (0) 38 200 23 505; info@pzap-ks.org; www.pzap-rks.org;

Tekst zyrtar

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Në bazë të nenit 115 paragrafi 1, nenit 117 paragrafi 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, të gjitha ndryshimet, *mutatis mutandis*, vlejnë edhe për Ligjin nr. 03/L-072, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, përveç nëse përcaktohet ndryshe më anë të këtij ligji nxjerr:

RREGULLEN Nr. 01/2012
PËR KATEGORIZIMIN E SANKSIONEVE DHE GJOBAVE

Neni 1
Përkufizimet

1.1 “Gjoba” nënkupton një shumë të hollave që shqiptohet për shkelje të dispozitave ligjore, të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256 dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, dhe për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulle për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave.

1.2 “Borxhi” nënkupton të gjitha shumat monetare të cilat subjekti politik është i detyruar t’ua paguaj personave të tjerë.

1.3 “Sanksioni” nënkupton masë ndëshkuese për shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256 dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, dhe për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulle për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave.

Neni 2
Dispozitat e Përgjithshme

2.1 Të gjithë personat dhe subjektet që marrin pjesë në procesin zgjedhor obligohen t’i respektojnë ligjet në fuqi dhe procesin zgjedhor, përfshirë edhe rregullat zgjedhore.

2.2 PZAP, vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000) euro.

2.3 Vendimi i PZAP-it, mund të apelohej në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr. 03/L-073 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256 dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nr. 03/L-072.

2.4 Çdo vendosje e një gjobe ose sanksioni tjetër nga PZAP-i, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksioni penal që mund të pasojë në të ardhmen.

2.5 Gjatë shqiptimit të një gjobe ndaj një subjekti politik, për ndonjë shkelje të legjisllacionit zgjedhor në Republikën e Kosovës, PZAP-i merr parasysh kriteret në vijim që ndikojnë në lartësinë e gjobës, respektivisht rrethanat rënduese dhe lehtësuese:

- a) Natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- b) Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- c) Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të legjisllacionit zgjedhor, në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- d) Përsëritja e shkeljes së natyrës së njëjtë nga Subjekti politik gjatë një procesi zgjedhor, nga PZAP do vlerësohet si rrethanë posaçërisht rënduese.
- e) Shumën e fondeve të cilat i merr subjekti politik, nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 3

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike Gjatë Periudhës së Fushatës Zgjedhore

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

3.1 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë heqjen, mbulimin, dëmtimin ose ndryshimin e ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllim të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me pesëmijënjëqind (5.100) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijëdhjetë (5.010) euro deri në dhjetëmijë (10.000) euro.

3.2 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë vendosjen e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me pesëmijëqind (5.100) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijëdhjetë (5.010) euro deri në dhjetëmijë (10.000) euro.

3.3 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij pa lejen paraprake ose autorizimin e organit kompetent, mbajnë ose ekspozojnë armë të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

3.4 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë çrregullimin e tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitjen e të tjerëve për një veprim të tillë,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

3.5 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij pengojnë ose tentojnë të pengojnë gazetarët për të përmbushur detyrat e tyre profesionale,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me pesëmijëqind (5.100) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijëdhjetë (5.010) euro deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro.

3.6 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij premtojnë ndonjë shpërblim financiar më qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me pesëmijëqind (5.100) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijëdhjetë (5.010) euro deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro.

3.7 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, kërcënojnë ose tentojnë për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

3.8 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij nxisin cilindo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

3.9 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij nxisin cilindo person për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të personit tjetër,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

3.10 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij abuzojnë me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me pesëmijëqind (5.100) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro.

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijëdhjetë (5.010) euro deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro.

3.11 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij përdorin gjuhën, në formë të shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

3.12 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij me qëllim të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij, duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili:

Është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë ; ose

Ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhrorit për t'u paraqitur para Tribunalit,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në tridhjetëmijë (30.000) euro.

Neni 4

Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor

4.1 Përdorimi ose kërcënimi me përdorim të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.

Për shkeljet nga pika 1 të këtij neni,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro, ndërsa,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me nëntëmijë (9.000) euro deri në dyzetmijë (40.000) euro.

4.2 Subjektit politik ose kandidatit iu ndalohet, inkurajimi, mbështetja ose miratimi i dhunës, kërcënimit me dhunë ose kanosjes, gjatë procesit zgjedhor.

Për shkeljet nga pika 2 të këtij neni,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro, ndërsa,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me nëntëmijë (9.000) euro deri në dyzetmijë (40.000) euro.

Neni 5

Veprimet e Ndaluara nga Shërbyesit Publik

5.1 Personi që mban pozitë publike, personi i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e asaj zyre me qëllim të përfitimit të votave.

Asnjë nga burimet e institucioneve të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.

Për shkeljet nga pika 1 të këtij neni,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro, ndërsa,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me dhjetëmijë (10.000) euro deri në dyzetmijë (40.000) euro.

Personit që mban pozitë publike apo personit të zgjedhur apo të caktuar i ndalohet të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor prej tre (3) viteve deri në gjashtë (6) vite.

5.2 Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjektit politik i ndalohet inkurajimi ose përfitimi nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose të saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

Për shkeljet nga pika 2 të këtij neni,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijë (6.000) euro deri në njëzetepesëmijë (25.000) euro, ndërsa,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me gjashtëmijë (6.000) euro deri në njëzetepesëmijë (25.000) euro.

Personit që mban pozitë publike apo personit të zgjedhur apo të caktuar i ndalohet të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor prej tre (3) viteve deri në gjashtë (6) vite.

Neni 6

Veprimet e Ndalura Para Procesit të Votimit

6.1 Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit.

Për shkeljen nga pika 1 e këtij neni,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijë (6.000) euro deri në njëzetepesëmijë (25.000) euro, ndërsa,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijepesëqind (5.500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro.

6.2 Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit, për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijepesëqind (6.500) euro deri në njëzetepesëmijë (25.000) euro,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me pesëmijepesëqind (5.500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro.

Neni 7

Deklarimi i Raportit Financiar Gjatë Fushatës

7.1 Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

Për shkeljet nga pika 1 të këtij neni,

Subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijë (6.000) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro, ndërsa,

Subjekti politik që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënohet me gjashtëmijë (6.000) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro.

Neni 8

Rastet me Elemente të Veprës Penale

Çdo vendosje e një gjobe ose ndonjë sanksioni tjetër nga PZAP-i, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksioni penal që mund të pasojë. Prandaj PZAP-i, të gjitha rastet të cilat kanë elemente të veprës penale, do ti procedojë në Prokurorinë Shtetërore për procedim të mëtejshëm.

Neni 9
Mënyra e Pagesës së Gjobës

9.1 Pala mund të marrë fletëpagesën për pagesën e gjobës vetëm në zyrën qendrore të PZAP-it.

9.2 Gjoba paguhet në monedhën e aplikueshme në Kosovë në kohën e pagesës.

9.3 Pala, pas pagesës së gjobës, është e obliguar të dorëzojë fletëpagesën, si dëshmi për pagesën e saj në PZAP.

9.4 Gjoba e paguar në PZAP, do të depozitohet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 10
Mos Pagesa e Gjobës së Shqiptuar

10.1 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it, brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

10.2 Në qoftë se subjekti politik dështon për të paguar dënimin e parë, respektivisht dënimin shtesë, PZAP-i për inkasimin e borxhit do të iniciojë procedurën përmbartimore në Gjykatën Kompetente.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hynë në fuqi më datën: **22. 11. 2012**

Shukri Sylejmani
Kryetar i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

